UDHËZIM
Nr.15, datë 6.8.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.4, DATË 30.1.2006 ”PËR MBLEDHJEN E KONTRIBUTEVE TË DETYRUESHME TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Pika 7 “Rimbursimi i kontributeve të paguara tepër”, e udhëzimit nr.4, datë 30.1.2006 ”Për mbledhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, ndryshohet si më poshtë:

1. Kthimi i shumave të paguara tepër ose rimbursimi i kontributeve

Në bazë të nenit 13 të ligjit nr.9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nëse si rezultat i një kontrolli ose për arsye të tjera shuma e kontributeve të paguara tejkalon shumën e llogaritur të detyrimeve për kontributet, dega përkatëse e tatimeve, rimburson diferencën brenda 30 ditëve nga zbulimi i mbipagesës ose nga paraqitja e kërkesës me shkrim prej tatimpaguesit.

Kthimi i shumave të paguara më tepër ose rimbursimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore mund të bëhet në një nga format e mëposhtme:

a) duke e kaluar shumën e paguar më tepër të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për llogari të pagimit të detyrimeve të papaguara të kontributeve të sigurimeve shoqërore ose shëndetësore;

b) duke e kaluar shumën e paguar më tepër të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me pëlqimin e tatimpaguesit, për llogari të pagimit të detyrimeve të mëvonshme të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;

c) duke e kaluar shumën e paguar më tepër në llogarinë e tatimpaguesit.

Nëse të gjitha ose pjesë të kontributeve të paguara lidhen me kontributet e punëmarrësit, punëdhënësi është përgjegjës për rimbursimin e punëmarrësve brenda 30 ditëve.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të përcaktojë rregullat për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode